



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA THEMELORE PEJË

---

Numri i lëndës: 2018:071903  
Datë: 18.04.2019  
Numri i dokumentit: 00284296

**P. nr. 1076/18**

**NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKATA THEMELORE NË PEJË D.P. , gjyqtari Sejdi Blakaj me sekretaren juridike Gjyljeta Çorkadiu , në lëndën penale kundër të pandehurit G. B. , sipas aktakuzës së PTH-së D.P. në Pejë PP/II. nr.2728/18 të dt.27.12.2018, për shkak të veprave penale: të sulmit nga neni 187 par 1 të KPRK-së dhe vepër penale : Asgjësimi apo dëmtimi i pronës nga neni 333 par 1 të KPRK-së, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar , publik dhe me gojë, të mbajtur në praninë të pandehurit G.B. dhe të prokurorit të shtetit Lumturije Hoxha , me dt.18.4.2019 ka marrë dhe botërisht ka shpallë këtë :

**AKTGJYKIM**

**I pandehuri G. B. i lindur me dt. ... në Pejë rruga....., ku edhe tani jeton, i biri i B. nënën F. e gjinisë M., i njohur me dokument identifikues numër ...., me profesion frizer, i martuar baba i 2 fëmijëve ,i gjendjes së dobët ekonomike , kinse i pa dënuar më parë nga gjykata, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës , gjendet në liri.**

**ËSHTË FAJTOR**

Për arsye se:

I. Me dt. 22.11.2018 rreth orës 16:30, në rrugën ...–Pejë , në lokalitetin e babait të tij B. B., me dashje përdorë forcën ndaj të dëmtuarit V. B. të cilin e ka vëlla , në atë mënyrë që, ditën kritike , i pandehuri pas një mosmarrëveshje që kishte pasur me babanë e tij ku i njëjti pasi ishte ndalur rryma në lokalitetin kishte dashur ta ndez një qiri, gjersa i pandehuri nuk kishte dashur ta lejoj duke i thënë ndeze gjeneratorin, e në këtë mënyrë i pandehuri i revoltuar del jashtë duke e përplasur derën e kur i dëmtuari V. , i drejtohet me fjalët mos e përplasë derën, i pandehuri kthehet brenda duke goditur xhamin e derës me dorë, e pastaj duke e sulmuar të dëmtuarin.

-me çka ka kryer veprën penale : të sulmit nga neni 187 par 1 të KPRK-së.

II. Me dt. 22.11.2018 rreth orës 16:30, në rrugën ....., pikërisht në lokalitetin e babait të tij me dashje dëmton pasurinë e të dëmtuarit B.B. të cilin e ka baba, në atë mënyrë që i pandehuri pas një mosmarrëveshje që kishte pasur me vëllain e tij dhe babanë e ka goditur me boks xhamin e lokalitetit të tyre, duke e dëmtuar.

-me çka ka kryer veprë penale : asgjësim apo dëmtimi i pronës nga neni 333 par 1 të KPRK-së.

Prandaj gjykata të pandehurit konform nenit 41, 85, 86 dhe nenit 187 par 1, 333 par 1 të KPRK-

Për veprën e parë penale nga neni 187 par 1 të KPRK-së dhe të dytë penale nga neni 333 par 1 të KPRK-së , I SHQIPTON

## **VËREJTJE GJYQËSORE**

Me të cilën të pandehurit i behët me dije se ka kryer veprat e dëmshme dhe të rrezikshme që përbënë veprë penale për të cilën nëse ai sërish e përsëritë gjykata do ti shqiptoi sanksion më të rëndë penal.

Obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 15 euro 15 ditë pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

Shpenzime procedurale nuk ka pasur

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Pejë me dt.27.12.2018 kundër të pandehurit G. B. ka ngritë aktakuzë PP/II. nr.2728/18 për shkak të veprave penale: I të sulmit nga neni 187 par 1 të KPRK-së dhe veprë penale : Asgjësimi apo dëmtimi i pronës nga neni 333 par 1 të KPRK-së, duke i propozuar gjykatës që pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor të pandehurin ta shpallë fajtorë, ta dënoj sipas ligjit dhe ta obligoj në pagimin e shpenzimeve procedurale .

Në shqyrtimin fillestarë i pandehuri – pasi që paraprakisht i është lexuar aktakuza , është njoftuar me të drejtat dhe detyrimet procedurale dhe pasojat e pranimi përkatësisht të mos pranimi të fajësisë- e ka pranuar fajësinë dhe ka manifestuar keqardhje për atë që i ka ndodhur. Këtë pranim fajësie gjyqtari – pasi që paraprakisht e ka marrë pëlqimin e prokurorit shtetit, të dëmtuarit B., i bindur se pranim fajësinë i pandehuri e ka bërë ashtu siç e parasheh ligji – vullnetarisht dhe pa u ndikuar nga askush dhe në asnjë mënyrë e ka pranuar .

Meqenëse i pandehuri e pranoj fajësinë gjyqtari kaloi në marrjen e vendimit lidhur me llojin dhe lartësinë e masës ndëshkuese , me ç rast i pati parasysh të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese. Rrethanë rënduese në rastin konkret gjyqtari nuk ka gjetur , kurse nga ato lehtësuese ka çmuar : pranimin e singertë të fajësisë , pendimin e thellë për këtë gjë, qëndrimin korrekt në gjykatë, pa dënueshmërinë e mëparshme, faktin se i pandehuri me të dëmtuarit është familjar :

B.in e ka baba V. vëlla , me ta është pajtuar dhe tani nuk e ka asnjë problem , ndërkohë që i dëmtuari B. në shqyrtim ka deklaruar se: “Të pandehurin e kam djalë, dhe e kam djalë të mirë. Nuk është e vërtetë se atë ditë ai na ka sulmuar , krejt çka ka bërë G.i është se e ka thyer xhamin , për çka menjëherë është penduar dhe ne menjëherë jemi pajtuar , sa i përket kërkesës pasurore juridike deklaroj se: nuk parashtroj kërkesë pasurore juridike dhe nuk i bashkëngjitëm ndjekjes penale”, dhe kështoj gjyqtari mendon se edhe me një vendim si në dispozitivin e aktgjykimit ndaj të pandehurit do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me neni 41 të KPK-së .

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor është marrë konform neni 450 të KPPRK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarit në kontestin civil është marrë konform neni 463 të KPRK-së

Nga sa u tha më lartë konform neni 365 të KPPRK-së u vendos si më lartë

Nga Gjykata Themelore në Pejë D.P. datë. 18.4.2019.

Sekretarja juridike  
Gjyljeta Çorkadiu

Gjyqtari  
Sejdi Blakaj

**KËSHILLA JURIDIKE**

Kundër këtij aktgjykimi lejohet  
Ankesa në afat prej 15 ditësh nga  
Dita e marrjes , Gjykatës të Apelit në Prishtinë  
E përmes kësaj Gjykate .